



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK)-NR. 05/2023 MASAT PËR
PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN E FËMIJËS NGA ABUZIMI ME
NARKOTIKË¹**

¹ Udhëzimi Administrativ (QRK)-Nr. 05/2023 Masat për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijës nga Abuzimi me Narkotikë, është miratuar në Mbledhjen e 145-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 08/145, të datës 07.06.2023.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me Nenin 43 (4) të Ligjit Nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës (Gazeta Zyrtare, Nr. 14, 17 korrik 2019, dhe Nenin 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare, nr. 15, 12 shtator 2011),

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK)-NR. 05/2023 MASAT PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN E FËMIJËS NGA ABUZIMI ME NARKOTIKË

KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë Udhëzim Administrativ për qëllim të mbrojtjes së fëmijës nga abuzimi me narkotikë, përcaktohen:
 - 1.1. masat parandaluese dhe mbrojtëse,
 - 1.2. masat për avokimin e mënyrës së shëndetshme të jetesës dhe dekurajimin e çdo lloj abuzimi me narkotikë, si dhe
 - 1.3. detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet:
 - 1.1. nga institucionet dhe nga personat fizik dhe juridik, të cilët punojnë me fëmijën dhe për fëmijën, e që kanë përgjegjësi për mbrojtjen e tyre nga çdo lloj abuzimi me narkotikë, në përputhje me obligimet e tyre të dala nga legjislacioni përkatës në fuqi dhe me këtë udhëzim administrativ, dhe
 - 1.2. për fëmijën me shtetësi kosovare, pa shtetësi, të pa regjistruar, azilkërkues, refugjat ose me shtetësi të huaj, brenda territorit të Republikës së Kosovës.

2. Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ nuk mund të merren si kufizim apo pakësim i të drejtave ekzistuese të fëmijës të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për mbrojtjen e fëmijës, Konventën për të Drejtat e Fëmijës ose me instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë fushë, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura për qëllim të këtij udhëzimi administrativ kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Fëmijë** – nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç;
 - 1.2. **Institucion** – nënkupton të gjitha institucionet, autoritetet, organet publike, të nivelit qendror dhe lokal, personat privat si bartës të autoriteteve publike si dhe personat e tjerë juridikë e privat në Republikën e Kosovës, që kanë përgjegjësinë për mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë;
 - 1.3. **Kodi penal** - Kodi nr. 06/L-074 penal të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 2, 14 janar 2019);
 - 1.4. **Komunë** – njësi e vetëqeverisjes lokale, në territorin dhe me kufijtë administrativë të përcaktuar sipas Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativ të komunave (Gazeta Zyrtare, nr. 26, 2 qershor 2008);
 - 1.5. **Konventa** - Konventa për të drejtat e fëmijës, 20 nëntor 1989;
 - 1.6. **Kushtetuta** – Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
 - 1.7. **Ligji për barnat narkotike**- Ligji nr. përkatës për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë;
 - 1.8. **Ligji për mbrojtjen e fëmijës** - Ligji përkatës për mbrojtjen e fëmijës;
 - 1.9. **Ligji për shëndetësi** - Ligji përkatës për shëndetësi;
 - 1.10. **Ligji për shërbime sociale dhe familjare** - Ligji përkatës për shërbime sociale dhe familjare;
 - 1.11. **Ministria** - Ministria përkatëse për shëndetësi;

- 1.12. **Narkotikë** - nënkupton barnat narkotike dhe substancat psikotrope, që janë përcaktuar si të tilla sipas Ligjit për barnat narkotike;
 - 1.13. **Në të gjitha fazat** - përfshin të gjitha procedurat në të cilat fëmija është në kontakt me institucionet përkatëse apo me profesionistët për mbrojtjen e fëmijës;
 - 1.14. **QPS** - Qendra për Punë Sociale.
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për mbrojtjen e fëmijës, Ligjin për barnat narkotike, Ligjin për shëndetësi dhe Ligjin për shërbime sociale dhe familjare.

KAPITULLI II - TË DREJTAT E FËMIJËS NË MASA PARANDALUESE DHE MBROJTËSE NGA ABUZIMI ME NARKOTIKË DHE PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZBATIMIN E TYRE

Neni 4

E drejta në masa parandaluese dhe mbrojtëse nga abuzimi me narkotikë

1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.
2. Çdo fëmijë ka të drejtë, për kujdes shëndetësor dhe për masa parandaluese dhe mbrojtëse nga abuzimi me narkotikë.
3. Mbrojtja e jetës dhe të drejtave të fëmijës është detyrimi kryesor, në masën maksimale të mundshme, për çdo person apo institucion.
4. Institucionet, në pajtim me përgjegjësitë e tyre, obligohen që të marrin masat e nevojshme parandaluese dhe mbrojtëse nga abuzimi me narkotikë, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi, këtë udhëzim administrativ si dhe politikat dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministria.
5. Masat parandaluese dhe mbrojtëse duhet të jenë adekuate, të vazhdueshme, për të gjithë dhe pa diskriminim, në përputhje me rregullat etike dhe profesionale.

Neni 5

Qëllimi i masave parandaluese dhe mbrojtëse

1. Qëllimi i masave parandaluese dhe mbrojtëse, nga abuzimi me narkotikë, është të:

- 1.1. mbrojtë fëmijën, nga shkaqet që mundësojnë përdorimin e narkotikëve dhe varshmërisë prej tyre;
 - 1.2. ngrit nivelin e njohurive dhe të vetëdijësojë popullatën për rrezikshmërinë e përdorimit të narkotikëve, dhe pasojat që sjell abuzimi me narkotikë për shoqërinë;
 - 1.3. sigurojë komunikimin efektiv dhe informativ për pasojat e dëmshme shëndetësore, natyrën e varshmërisë, kërcënimet vdekjeprurëse që paraqet konsumimi i narkotikëve;
 - 1.4. jap këshilla kundër përdorimit të narkotikëve;
 - 1.5. inkurajojë ndërprerjen e përdorimit të narkotikëve, nga përdoruesit;
 - 1.6. promovojë një mënyre të shëndetshme të jetesës;
 - 1.7. dekurajojë çdo lloj abuzimi me narkotikë, si dhe
 - 1.8. zvogëlojë numrin e fëmijëve që abuzojnë me narkotikë.
2. Përmes masave parandaluese dhe mbrojtëse nga narkotikët, objektivi kryesor i institucioneve, duhet të jetë sigurimi, në masën maksimale të mundshme, i mbijetesës, zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijës.

Neni 6

Përgjegjësitë në zbatimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse

1. Prindërit apo kujdestarët e fëmijës, institucionet dhe të gjithë personat fizik dhe juridik, të cilat punojnë me fëmijën, kanë përgjegjësi të përkujdesen për shëndetin e fëmijës dhe të mbrojnë atë, nga abuzimi me narkotikë.
2. Veprimet e ndërmarra për të parandaluar dhe mbrojtur nga çdo lloj abuzimi me narkotikë, duhet të bazohen në dispozitat e parapara me Kushtetutë, legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare si dhe të garantohen liritë dhe të drejtat e të gjithë personave.

Neni 7

Ofrimi pa diskriminim i masave parandaluese dhe mbrojtëse

1. Fëmijët kanë të drejtë të qasjes së barabartë në masat parandaluese dhe mbrojtëse nga abuzimi me narkotikë.

2. Ofrimi dhe zbatimi i masave parandaluese dhe mbrojtëse, të ndërmarra nga institucionet, me qëllim të mbrojtjes së fëmijës nga abuzimi me narkotikë, duhet të jenë në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë, në mënyrë që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit, sipas kuptimit të cilido nga bazat e përcaktuara në dispozitat përkatëse të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.
3. Secili person i cili konsideron se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj fëmijës, gjatë ofrimit dhe zbatimit të masave parandaluese dhe mbrojtëse nga abuzimi me narkotikë, mund të iniciojnë procedurë dhe paraqesin fakte para organit kompetent, në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Neni 8

Interesi më i mirë i fëmijës gjatë zbatimit të masave parandaluese dhe mbrojtëse

Të gjitha masat parandaluese dhe mbrojtëse, të ndërmarra nga institucionet, me qëllim të mbrojtjes së fëmijës nga abuzimi me narkotikë, duhet të jenë në interesin më të mirë të fëmijës dhe interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese, në përputhje dhe me respektimin e të drejtave dhe lirive të fëmijës të parapara në Kushtetutë, Konventë, Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

KAPITULLI III - MASAT PARANDALUESE DHE MBROJTËSE NGA ABUZIMI ME NARKOTIKË

Neni 9

Edukimi i fëmijës

Familja, institucionet dhe profesionistët që punojnë me dhe për fëmijën, duhet të përkujdosen që të edukojnë fëmijët me qëllim që ata të marrin njohuri për mbrojtje nga abuzimi me narkotikë.

Neni 10

Parandalimi dhe mbrojtja e fëmijës nga abuzimi me narkotikë

1. Institucionet, në fushën e përgjegjësisë së tyre, duhet të zhvillojnë masa dhe të ndërmarrin veprime për të parandaluar dhe mbrojtur fëmijët nga abuzimi me narkotikë.
2. Masat dhe veprimet parandaluese, kundër abuzimit me narkotikë duhet të:
 - 2.1. bazohen në nevojat e fëmijës;
 - 2.2. jenë të arritshme, me kohë;
 - 2.3. kenë efekt pozitiv afatgjatë;

- 2.4. sigurojnë zhvillim optimal të fëmijës;
 - 2.5. promovojnë ose të avokojnë për një mënyrë të shëndetshme të jetesës;
 - 2.6. dekurajojnë çdo lloj abuzimi me narkotikë;
 - 2.7. mbështesin marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe personave që rrisin fëmijën;
 - 2.8. promovojnë ose të kryejnë fushata për rritjen e sensibilitetit drejtuar publikut të gjerë, duke dhënë informacion për fenomenin e abuzimit me narkotikë dhe për masat parandaluese që mund të ndërmerren;
 - 2.9. mbrojnë fëmijën nga hyrja në klubet e natës, si dhe në qendrat argëtuese për të rritur dhe të ngjashme;
 - 2.10. përfshijnë mediat, kanalet informative dhe rrjetet sociale, të informojë popullatën për mënyrat e parandalimit dhe luftimit të narkomanisë;
 - 2.11. mbrojnë fëmijën nga ndikimet e mundshme negative nga publikimet, filmat, video lojërat, muzika, faqet e internetit, transmetimet ose llojet e tjera të komunikimit masiv, të cilat rrezikojnë dhe dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës dhe të cilat nxisin përdorimin e narkotikëve.
3. Masat dhe veprimet parandaluese kundër abuzimit me narkotikë, të zbatuara nga institucionet, për të arritur efikasitetin e duhur, mbështeten nga zyrtarët ligj zbatues.

Neni 11

Përgjegjësia familjare për përkujdesjen për fëmijën nga abuzimi me narkotikë

1. Familja, ka përgjegjësi primare për rritjen, mirëqenien, edukimin dhe mbrojtjen e fëmijës si dhe të përkujdeset për t'i siguruar fëmijës jetën, sigurinë, shëndetin, mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor si dhe mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha aktet dhe situatat që e vënë fëmijën në rrezik, nga përdorimi apo abuzimi me narkotikë.
2. Institucionet përkatëse për mbrojtjen e fëmijës, në fushën e përgjegjësisë së tyre, ndihmojnë dhe ndërhyjnë në familje, në bazë të referimit apo në raste kur familja nuk është në gjendje apo kur ekziston dyshimi i bazuar se familja nuk është në gjendje që të mbrojë fëmijën nga rreziku i përdorimit të narkotikëve.

Neni 12

Mbështetja e familjeve në përkujdesjen për fëmijën nga abuzimi me narkotikë

1. Institucionet, në fushën e përgjegjësisë së tyre, duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar integritetin e fëmijës në familje dhe shoqëri dhe të promovojnë mirëqenien e fëmijës në suaza të familjes së tij biologjike, përmes ofrimit të përkujdesjes, mbrojtjes dhe

këshillimit social, për të parandaluar përdorimin e narkotikëve.

2. Institucionet, janë të obliguar të bëjnë:
 - 2.1. sigurimin e rrjetit të shërbimeve cilësore dhe të arritshme për kujdesin e fëmijës;
 - 2.2. hartimin e programeve për të përmirësuar aftësitë prindërore dhe për të nxitur një mjedis të shëndetshëm dhe pozitiv familjar për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë dhe promovimin e një mënyre të shëndetshme të jetesës;
 - 2.3. zhvillimin dhe promovimin e prindërimit pozitiv;
 - 2.4. njohjen e fëmijës si individë në të drejtën e tyre.
3. Kujdesi i institucionalizuar duhet të përdoret vetëm në interesin më të mirë të fëmijës, si një çështje të instancës së fundit, për periudhën më të shkurtër të mundshme të kohës, dhe që ka si objekt kryesor integrimin e suksesshëm dhe/apo ri-integrimin e fëmijës në shoqëri.

Neni 13

Fushatat informuese dhe vetëdijesuese

1. Institucionet, në fushën e përgjegjësisë së tyre, zhvillojnë fushata informimi dhe vetëdijësi, që fokusohen veçanërisht në ngritjen e vetëdijës së:
 - 1.1. familjes për rrezikun e përdorimit të narkotikëve nga fëmijët, dhe
 - 1.2. fëmijëve për rrezikun e përdorimit të narkotikëve.
2. Fushatat e informimit dhe vetëdijësit duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara në aspektin e dërgimit të mesazhit tek grupet e interesit dhe mobilizimin e tyre për kauzën e mbrojtjes së fëmijës nga përdorimi i narkotikëve.

Neni 14

Inkurajimi i shoqërisë civile dhe sektorit privat në zbatimin e politikave për mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë

Institucionet, në fushën e përgjegjësisë së tyre, duhet të inkurajojnë shoqërinë civile si dhe sektorin privat, që të marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë, si dhe të bëjnë financimin, ku është e mundur, të projekteve dhe programeve, që kryhen nga shoqëria civile dhe sektori privat.

Neni 15

Inkurajimi i mediave në informimin për efektet e dëmshme të narkotikëve

1. Institucionet, duke respektuar pavarësinë e medias dhe lirinë e shtypit, në pajtim me të drejtat dhe detyrimet e tyre, inkurajojnë mediat që të ndikojnë në edukimin e fëmijëve dhe të rriturve dhe të japin informacionin e duhur për efektet e dëmshme të narkotikëve.
2. Institucionet mund të bëjnë financimin e programeve dhe të fushatave, për të bërë avokimin e një mënyre të shëndetshme të jetesës dhe dekurajimin e çdo lloj abuzimi me narkotikë.

Neni 16

Pjesëmarrja e fëmijës në zhvillimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen nga abuzimi me narkotikë

Institucionet, në fushën e përgjegjësisë së tyre, inkurajojnë pjesëmarrjen e fëmijës, në përputhje me kapacitetin e tyre zhvillimor, në zhvillimin dhe zbatimin e politikave, programeve ose iniciativave të tjera për mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë.

Neni 17

Raportimi i abuzimit me narkotikë

1. Çdo person që punon me dhe për fëmijën, i cili dyshon ose ka dëshmi se fëmija është i përfshirë në mënyrë të paautorizuar në blerjen, posedimin, shpërndarjen, shitjen, prodhimin, dhe në veprat tjera penale të përcaktuara në Kapitullin XXIII (Veprat penale të narkotikëve) të Kodit Penal, është i obliguar që të raportojë rastin në Polici ose në Qendrën për Punë Sociale.
2. Ministria përkatëse për punë të brendshme, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi, duhet të marrë masat e domosdoshme për të siguruar:
 - 2.1. rritjen e vetëdijesimit për raportimin nga çdo person që di ose dyshon se një fëmijë është viktimë e abuzimit me narkotikë;
 - 2.2. që çdo raportim të rasteve për abuzim me narkotikë do të mbetet konfidencial dhe
 - 2.3. mbrojtje për personat që raportojnë rastet e abuzimit me narkotikë.
3. Mos raportimi i rasteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, sanksionohet sipas dispozitave të ligjit në fuqi.

4. Ministria, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse për punë sociale, ministrinë përkatëse për punë të brendshme dhe ministrinë përkatëse për drejtësi, nxjerr udhëzues për zbatimin e këtij neni.

Neni 18

Trajnimi për aspekte të mbrojtjes së fëmijës nga përdorimi i narkotikëve

1. Institucionet organizojnë dhe obligojnë punonjësit, që kanë përgjegjësi direkte në mbrojtjen e fëmijës, për pjesëmarrje në trajnime për aspekte të mbrojtjes së fëmijës nga përdorimi i narkotikëve.
2. Punonjësit që kanë përgjegjësi direkte në mbrojtjen e fëmijës, janë të obliguar të ndjekin trajnimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, si dhe të venë në shfrytëzim në punën e tyre të përditshme, njohurinë dhe dijen e përftuar.
3. Profesionistit që punon për dhe me fëmijën, që ka abuzuar me narkotikë, duhet t'i ofrohet trajnim i specializuar dhe trajnim i rregullt dhe i vazhdueshëm për të zhvilluar aftësitë e tij, si dhe për të përmirësuar njohuritë e tyre teorike dhe praktike.
4. Instituti i Kosovës për Administratë Publike, Akademia e Drejtësisë, Akademia për Siguri Publike, në bashkëpunim dhe koordinim me Ministrinë dhe odat përkatëse të profesionistëve shëndetësor, përgatisin programe të posaçme për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e mbrojtjes së fëmijës nga përdorimi i narkotikëve.

Neni 19

Avokimi për mënyrën e shëndetshme të jetesës dhe dekurajimi i çdo lloj abuzimi me narkotikë

1. Avokimi për mënyrën e shëndetshme të jetesës dhe dekurajimi i çdo lloj abuzimi me narkotikë:
 - 1.1. nuk duhet të fokusohet vetëm në qëndrimin negativ ndaj narkotikëve dhe dekurajimin e çdo lloj abuzimi me to, por edhe në promovimin e një stili jetese të shëndetshëm, formimin e tij social, përvetësimin e aftësive të dobishme dhe mënyrave të vetë-realizimit;
 - 1.2. duhet të jenë “miqësore për fëmijë”;
 - 1.3. mund të organizohet përmes ngjarjeve të ndryshme të artit, kulturës dhe sportit, në avokimin e një mënyre të shëndetshme të jetesës dhe dekurajimin e çdo lloj abuzimi me narkotikë.

KAPITULLI IV - ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE NË OFRIMIN DHE ZBATIMIN E MASAVE PARANDALUESE DHE MBROJTËSE NGA ABUZIMI ME NARKOTIKË

Neni 20

Bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve

1. Me qëllim të mbrojtjes së fëmijës nga abuzimi me narkotikë, institucionet në pajtim me fushëveprimin e tyre, janë të obliguara të:
 - 1.1. ndërmarrin masat e domosdoshme për të siguruar bashkërendimin dhe bashkëpunimin në nivel vendi si dhe në nivel rajonal dhe ndërkombëtar me qëllim të mbrojtjes së fëmijës nga abuzimi me narkotikë;
 - 1.2. shkëmbejnë informata, përvoja, formojnë grupe punese të nevojshme për parandalimin dhe luftimin efikas të abuzimit të narkotikëve si dhe parandalimit, trajtimit dhe rehabilitimit të suksesshëm të sëmundjeve të varësisë;
 - 1.3. inkurajojnë bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërmjet autoriteteve kompetente shtetërore, të shoqërisë civile, mediave, sektorit privat, dhe punojnë intensivisht për të ndarë praktikat dhe modelet pozitive në lidhje me mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë.
2. Mbrojtja e fëmijës nga narkotikët, është një përgjegjësi e të gjitha institucioneve të cilat duhet të ndërtojnë qasjen gjithëpërfshirëse për të gjithë anëtarët e shoqërisë.

Neni 21

Roli dhe përgjegjësitë e Komitetit Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës

1. Komiteti Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës, i themeluar sipas nenit 16 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës, për të siguruar parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë, ndërmerr veprimet si në vijim:
 - 1.1. definojnë prioritetet dhe masat e nevojshme që duhen ndërmarrë nga institucionet përkatëse, për përmirësimin e situatës në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga ndikimi i dëmshëm i narkotikëve, sipas propozimit të Ministrisë;
 - 1.2. mbështet zhvillimin dhe zbatimin e fushatave promovuese për të rritur vetëdijësimin për mbrojtjen e shëndetit të fëmijës nga abuzimi me narkotikë;
 - 1.3. lehtëson dhe monitoron zbatimin e politikave, programeve dhe masave të tjera të aprovuara që kanë të bëjnë me parandalimin dhe mbrojtjen nga narkotikët;

- 1.4. sipas nevoje dhe apo propozimit të Ministrisë, themelon grupe punuese të nevojshme për trajtimin e çështjeve të mbrojtjes së shëndetit të fëmijës nga ndikimi i dëmshëm i narkotikë;
- 1.5. sipas propozimit të Ministrisë, miraton Planin e veprimit për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijës abuzues me narkotikë.

Neni 22

Roli dhe përgjegjësitë e Komisionit për Narkotikë

1. Komisioni për Narkotikë, i themeluar sipas nenit 6 të Ligjit për barnat narkotike, për të siguruar parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë, ndërmerr veprimet si në vijim:
 - 1.1. informon publikun për pasojat e abuzimit të narkotikëve tek fëmijët;
 - 1.2. mbledh dhe përpunon të dhëna përkitazi me natyrën dhe për shtrirjen territoriale të përdorimit dhe abuzimit me narkotikë nga fëmijët;
 - 1.3. koordinon dhe përkrah aktivitetet e organizatave joqeveritare dhe organizatave të tjera në parandalimin dhe mbrojtjen e abuzimit me narkotikë nga fëmijët.
2. Komisioni për Narkotikë, bashkëpunon me Komitetin Ndërmnistror për të Drejtat e Fëmijës dhe sipas nevoje dhe kërkesës raporton në Komitet.

Neni 23

Roli dhe përgjegjësitë e Këshillit për të drejtat e fëmijës

1. Këshilli për të drejtat e fëmijës, i themeluar sipas nenit 18 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës, për të siguruar parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë, ndërmerr veprimet si në vijim:
 - 1.1. këshillon Komitetin, për masat e nevojshme që duhet ndërmarrë për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë për mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë;
 - 1.2. në bashkëpunim me Ministrinë, realizon fushata informuese dhe projekte të tjera promovuese për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e abuzimit me narkotikë nga fëmija;

- 1.3. realizon fushata avokimi për një mënyrë të shëndetshme të jetesës dhe dekurajimin e çdo lloj abuzimi me narkotikë.

Neni 24

Roli dhe përgjegjësitë e Ministrisë

1. Ministria, për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë, ndërmer veprimet si në vijim për të siguruar:
 - 1.1. rritjen e vetëdijesimit, përmes mjeteve të informimit publik dhe fushatave mediatike, me theks të veçantë për efektet e dëmshme që kanë narkotikët për fëmijën;
 - 1.2. zgjerimin e shërbimeve detoksikuese në repartet psikiatrike të spitaleve regjionale;
 - 1.3. trajnime të vazhdueshme për personelin shëndetësor për kontrollimin dhe trajtimin e fëmijës që ka abuzuar me narkotikë;
 - 1.4. hartimin e programeve që parandalojnë përdorimin e narkotikëve dhe që inkurajojnë fëmijën të ndërpresin përdorimin e tyre;
 - 1.5. hartimin e udhërrëfyesve dhe protokollet përkatëse klinike, të nevojshme në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë;
 - 1.6. hartimin dhe mbikëqyrjen e Procedurave Standarde Operative, duke përfshirë edhe inspektimin sipas nevojës, përmes inspektoratit farmaceutik dhe inspektoratit shëndetësor;
 - 1.7. hartimin e udhëzuesve të nevojshëm për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ, si dhe
 - 1.8. hartimin dhe zbatimin e Planit të veprimit për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijës abuzues me narkotikë.

Neni 25

Roli dhe përgjegjësitë e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike

1. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë, ndërmer veprimet si në vijim për të siguruar:
 - 1.1. mbledhjen dhe analizën e të dhënave për shfrytëzuesit dhe abuzuesit me narkotikë, duke përfshirë edhe fëmijët;
 - 1.2. krijimin e bazës së të dhënave për regjistrim të personave përdorues të narkotikëve;
 - 1.3. koordinimin me institucione dhe punëtorë shëndetësorë dhe jo shëndetësorë, për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve të varësisë nga narkotikët;
 - 1.4. hartimin e programeve, përpilimin, publikimin dhe shpërndarjen e materialeve informuese, edukuese dhe këshilluese (IEK), lidhur me shkaktarët dhe pasojat nga përdorimi i narkotikëve tek fëmijët;

- 1.5. promovimin dhe edukimin shëndetësorë për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve të varësisë nga narkotikët tek fëmijët;
 - 1.6. promovimin dhe edukimin për mënyrën e shëndetshme të jetesës dhe dekurajimin e çdo lloj abuzimi me narkotikë;
 - 1.7. organizimi i debateve me qëllim informimi dhe vetëdijesimi për dukurinë e narkotikëve.
2. Institucionet, të cilat merren me identifikimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve të varësisë, janë të obliguara të raportojnë në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike, për rastet e përdoruesve të narkotikëve, duke përfshirë edhe fëmijët përdorues të narkotikëve.

Neni 26

Roli dhe përgjegjësitë e ministrisë përkatëse për arsim

1. Ministria përkatëse për arsim, për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë, ndërmer veprimet si në vijim për të siguruar:
 - 1.1. hartimin dhe zbatimin e kurikulave shkollore me qëllim të edukimit dhe vetëdijesimit të nxënësve për të njoftuar dhe paralajmëruar fëmijët dhe të rinjtë për dëmet shëndetësore të narkotikëve;
 - 1.2. përfshirjen e të drejtave të fëmijës në programet shkollore dhe promovimin e një qasjeje për të drejtat e fëmijës në të gjitha nivelet e arsimit;
 - 1.3. organizimin e takimeve me prindër, me qëllim të informimit lidhur me rolin e tyre në fushën e parandalimit të konsumimit të narkotikëve;
 - 1.4. trajnimin e mësimitdhënësve lidhur me identifikimin e hershëm të fëmijëve përdorues të narkotikëve.
 - 1.5. informata tek nxënësit për rreziqet dhe pasojat e narkotikëve, si dhe për mjetet për të mbrojtur vetveten, të përshtatura sipas kapaciteteve të tyre zhvillimore;
 - 1.6. që institucionet, që merren me edukimin dhe arsimimin e fëmijës, të ndërmarrin aktivitete që promovojnë vetëdijesimin e fëmijës mbi dëmet që shkaktojnë narkotikët.

Neni 27

Roli dhe përgjegjësitë e ministrisë përkatëse për mirëqenie sociale

1. Ministria përkatëse për mirëqenie sociale, për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë, ndërmer veprimet si në vijim për të siguruar:
 - 1.1. identifikimin dhe evidentimin e fëmijëve përdorues të narkotikëve, të familjeve që janë shfrytëzues të ndihmave dhe shërbimeve sociale;
 - 1.2. hartimin e planeve për mbrojtjen e fëmijës, nga radhët e familjeve ose individëve që janë përdorues të narkotikëve;

- 1.3. trajnime të rregullta dhe të vazhdueshme për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi me narkotikë, për të gjithë punonjësit e QPS, që punojnë me dhe për fëmijët;
- 1.4. mbështetjen e institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal, si dhe organizatat e tjera, që ofrojnë mbrojtje për fëmijët, në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave në fushën e mbrojtjes së fëmijës nga abuzimi me narkotikë.

Neni 28

Roli dhe përgjegjësitë e ministrisë përkatëse për punë të brendshme

1. Ministria përkatëse për punë të brendshme, përmes njësive organizative, është institucioni përgjegjës qeveritar që udhëheq në hartimin dhe monitorimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e sigurisë së përgjithshme dhe narkotikëve.
2. Përmes mekanizmave dhe agjencive të saj, ministria përkatëse për punë të brendshme duhet të ndërmerret aktivitetet në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj të gjitha aktiviteteve kundër narkotikëve.

Neni 29

Roli dhe përgjegjësitë e Policisë së Republikës së Kosovës

1. Policia e Republikës së Kosovës, përmes Drejtorisë për hetimin e trafikimit me narkotikë dhe strukturave tjera mbështetëse në kuadër të Policisë së Kosovës, ka përgjegjësinë kryesore në luftimin e keqpërdorimit të narkotikëve, dhe për këtë qëllim, kryejnë aktivitetet e përcaktuara sipas detyrave zyrtare:
 - 1.1. shtojnë veprime policore me qëllim të parandalimit të ofertës dhe furnizimit me narkotikë në ambientet shkollore dhe në zonën e sigurisë së tyre;
 - 1.2. bëjnë evidentimin e paraqitjeve të veprave penale dhe kundërvajtjeve përkitazi me narkotikët;
 - 1.3. bashkëpunojnë me agjencitë dhe organizatat e vendeve tjera për identifikimin, luftimin dhe parandalimin e keqpërdorimit të narkotikëve.
2. Policia përmes Drejtorisë për hetimin e trafikimit me narkotikë, për mbrojtjen dhe parandalimin e keqpërdorimit me narkotikë, ka përgjegjësitë, që përfshihen por nuk kufizohen, si vijim:
 - 2.1. identifikimin e fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe referimi në kohë tek QPS;

- 2.2. mbrojtjen e fëmijës në rrezik të menjëhershëm dhe referimin e tyre pranë QPS;
- 2.3. bën lëshimin apo kërkesë për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, për fëmijën në rrezik të lartë ose të menjëhershëm, në bashkëpunim me QPS, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 2.4. parandalimin e abuzimit me narkotikë, përmes mbështetjes së QPS për aktivitetet parandaluese;
- 2.5. mbështetjen e QPS kur është e nevojshme, gjatë vizitave në familje, gjatë identifikimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijës që është në rrezik të lartë ose të menjëhershëm, të përdorimit të narkotikëve.

Neni 30

Roli dhe përgjegjësitë e komunës

1. Secila komunë, brenda territorit të saj, është përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve dhe masave parandaluese, mbrojtëse dhe ri integruese për mbrojtjen e fëmijës nga ndikimi i dëmshëm i narkotikëve, sipas standardeve dhe politikave të përcaktuara nga Qeveria apo ministritë përkatëse.
2. Organet dhe administrata komunale, brenda territorit të saj, duhet të marrin hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për mbrojtjen e fëmijës, nga ndikimi i dëmshëm i narkotikëve. Në këtë drejtim ato duhet të:
 - 2.1. zhvillojnë programe dhe projekte për të parandaluar dhe mbrojtur fëmijët nga ndikimi i dëmshëm i narkotikëve;
 - 2.2. marrin hapa për të identifikuar natyrën dhe nevojën për mbrojtjen e fëmijës nga përdorimi i narkotikëve;
 - 2.3. zhvillojnë masa për të parandaluar rreziqet për mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës, nevojën e fëmijës për ndihmë dhe për të zvogëluar problemet ekzistuese;
 - 2.4. zhvillojnë programe dhe projekte për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që vënë në rrezik fëmijët nga përdorimi i narkotikëve;
 - 2.5. organizojnë takime informuese, promovuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës nga përdorimi i narkotikëve;
 - 2.6. promovojnë një mënyre të shëndetshme të jetesës dhe dekurajimin e çdo lloj abuzimi me narkotikë;
 - 2.7. krijojnë një sistem që të jenë më pranë fëmijës;
 - 2.8. përkrahin ekzekutimin e masave të diversitetit dhe masave edukative për fëmijë që kanë abuzuar me narkotikë;
 - 2.9. zhvillojnë praktika të prindësisë së mirë dhe promovimit shëndetësor;

- 2.10. komunikojnë dhe mund të krijojnë partneritet me komunat tjera dhe me institucionet qendrore dhe organizatat dhe institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, grupet e të rinjve dhe mediat për t'i promovuar të drejtat e fëmijëve dhe masat për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga përdorimi i narkotikëve, në mënyrë që në komunë të sigurohet një mjedis i sigurt për fëmijët.
3. Për ushtrimin më efikas dhe më efektiv të mbrojtjes së fëmijës nga përdorimi i narkotikëve, komuna mund të hyjë në marrëdhënie bashkëpunimi me dy apo më shumë komuna të Republikës së Kosovës në pajtim me format, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin për bashkëpunim ndër komunal.

Neni 31

Roli dhe përgjegjësitë e Qendrës për Punë Sociale

1. QPS, ofron përkujdesje sociale dhe/ose këshillim në rrethanat kur një fëmijë është në nevojë për shërbime sociale dhe familjare dhe duhet të marrë çdo hap të nevojshëm për ruajtjen e sigurisë së fëmijës dhe siguron që shërbimet e ofruara janë në përputhje me përgjegjësitë që përmban Ligji për shërbime sociale dhe familjare, Ligji për mbrojtjen e fëmijës dhe legjislacioni përkatës në fuqi.
2. QPS identifikon rastet e fëmijës që ka abuzuar, apo është në rrezik të abuzimit me narkotikë, nëpërmjet informacioneve të siguruar nga vetë QPS-ja, marrjes së referimeve nga institucionet e tjera, anëtarët e komunitetit, publiku, vetë fëmija/ët dhe media.
3. QPS, sipas përgjegjësisë të përcaktuara në Nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës, duhet që të:
 - 3.1. zbatojë politikat shtetërore dhe lokale për mbrojtjen e fëmijës nga përdorimi i narkotikëve;
 - 3.2. shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në kuadër të komunës, mund të informohen apo të referohen te shërbimet apo institucionet e tjera mbështetëse për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga narkotikët, sipas nevojave që ata kanë;
 - 3.3. menaxhojë rastin emergjent të fëmijës përdorues të narkotikëve, në bashkëpunim me policinë dhe akterë tjerë të nevojshëm, edhe jashtë orarit zyrtar të punës;
 - 3.4. ndër marr vlerësime fillestare për të gjithë rastet e fëmijës të referuar në QPS;
 - 3.5. organizojë vlerësime të thella e të plota për fëmijën përdorues të narkotikëve;
 - 3.6. zhvillojë dhe shqyrtojë planet individuale të fëmijës përdorues të narkotikëve dhe të bëjë monitorimin e zbatimit derisa rasti të mbyllet;
 - 3.7. denoncojë në polici të rastet e abuzimit me narkotikë nga fëmija;

- 3.8. veprojë si Menaxher Rasti dhe të jetë përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e Programit të Mbrojtjes së Fëmijës, edhe në rastet kur fëmija është në një institucion rezidencial ose në çfarëdo lloji strehimi të përkohshëm;
- 3.9. mbajë të dhëna të sakta dhe faktike për të gjitha rastet e menaxhuara dhe referuara të fëmijës që ka abuzuar me narkotikë, pranë QPS;
- 3.10. organizojë fushata promovuese dhe vetëdijësuese për parandalimin e përdorimit të narkotikëve, si dhe
- 3.11. ushtrojë çdo kompetencë tjetër, në përmbushjen e mandatit që ka, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 32

Roli dhe përgjegjësitë e Ekipit për të drejtat e fëmijës

1. Ekipi për të Drejtat e Fëmijës, i themeluar sipas nenit 20 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës, në të gjitha Komunitetet e Republikës së Kosovës, ka përgjegjësi:
 - 1.1. për definimin e prioriteteve të komunës dhe masave të nevojshme që duhet ndërmarrë për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga narkotikët;
 - 1.2. për zhvillimin e programeve, për të parandaluar përfshirjen e fëmijës në abuzimin me narkotikë;
 - 1.3. që të rekomandojë kryetarin e komunës për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejme, të nevojshme për të realizuar mbrojtjen e fëmijës nga përdorimi i narkotikëve.

Neni 33

Roli dhe përgjegjësitë e drejtorive komunale përkatëse për arsim dhe shkollave

1. Roli dhe përgjegjësitë e drejtorive komunale përkatëse për arsim dhe institucioneve edukative arsimore përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - 1.1. parandalimin dhe edukimin e fëmijës për të shmangur situatat e rrezikshme nga përdorimi i narkotikëve;
 - 1.2. identifikimin e fëmijës që kanë abuzuar me narkotikë dhe referimin në kohë pranë QPS;
 - 1.3. lehtësimin dhe mbështetjen për ndjekjen e shkollës nga fëmijët të cilët kanë abuzuar me narkotikë;
 - 1.4. marrjen pjesë në takimin e Tryezës Multidisiplinare dhe mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën që ka abuzuar me narkotikë.

2. Drejtoritë përkatëse të arsimit në nivel komunal, në koordinim dhe bashkëpunim me shkollat duhet që të organizojnë trajnime të veçanta me të gjithë personelin e punësuar në shkollë, në të gjitha nivelet e arsimit para universitar me qëllim të informimit rreth rreziqeve të përdorimit të narkotikëve.
3. Shkollat duhet të angazhojnë me theks të veçantë psikologët për t'i mbështetur fëmijët që kanë krijuar varësi na përdorimi i narkotikëve.
4. Drejtori i shkollës së bashku dhe në koordinim me kujdestarët e klasave duhet të kujdesen që brenda hapësirave të shkollës, të mos lejohet posedimi dhe përdorimi i narkotikëve dhe të identifikojnë dhe të bëjnë referimin e menjëhershëm të rastit pranë policisë dhe/apo QPS.

Neni 34

Roli dhe përgjegjësitë e ofruesit të kujdesit shëndetësor

1. Roli dhe përgjegjësitë e ofruesit e kujdesit shëndetësor përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - 1.1. identifikimin e fëmijës abuzues me narkotikë dhe referimin e menjëhershëm të rastit pranë policisë dhe/apo QPS;
 - 1.2. përpilimin e raporteve mjekësore mbi gjendjen shëndetësore të fëmijës së abuzuar apo të supozuar si të abuzuar me narkotikë;
 - 1.3. ofrimin me prioritet të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë kontrollet dhe analizat përkatëse të fëmijës që ka abuzuar me narkotikë;
 - 1.4. pjesëmarrje në takimet e Tryezave Multidisiplinare, mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën.

Neni 35

Përgjegjësia individuale

1. Çdo person fizik dhe juridik mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të këtij udhëzimi administrativ dhe të legjislacionit përkatës, për mbrojtjen e fëmijës nga përdorimi i narkotikëve, kur me veprimet ose mosveprimet e tij, ka bërë shkeljen e dispozitave përkatëse në fuqi dhe nuk ka kryer detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.
2. Institucionet për mbrojtjen e fëmijës janë të obliguara që pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësive të tyre.

3. Dështimi apo pengimi për të përmbushur ndonjërin prej obligimeve të përcaktuara në këtë udhëzim administrativ dhe legjislacionin përkatës në fuqi, do merret si bazë për të ndërmarrë masa ndëshkuese dhe disiplinore konform ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 36

Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare për mbrojtjen e fëmijës

1. Organet dhe administrata komunale dhe institucionet tjera:
 - 1.1. bashkëpunojnë me organizatat joqeveritare për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga përdorimi i narkotikëve, si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen dhe trajtimin e tyre, në pajtim me këtë udhëzim administrativ dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
 - 1.2. sigurojnë, inkurajojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen e organizatave joqeveritare në çështjet e mbrojtjes së fëmijës dhe në aktivitetet planifikuese dhe zbatuese si dhe u ofrojnë këshilla dhe udhëzime organizatave që kërkojnë të ndërmarrin aktivitete të tilla.
 - 1.3. Mbajnë komunikime të rregullta me organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e fëmijëve në komunë nga një perspektivë tjetër.
2. Organizatat joqeveritare të licencuara nga Ministria përkatëse për mirëqenie sociale, sigurojnë shërbimet përkatëse të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, qoftë me nismën e tyre ose me kontratë.
3. Administrata dhe organet komunale mund të hyjnë në kontrata me organizatat joqeveritare për ofrimin e shërbimeve të veçanta sociale dhe familjare brenda territorit të tyre. Kontratat e tilla duhet të jenë në pajtim me planet vjetore të komunës për shërbime sociale dhe familjare, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

KAPITULLI V - PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN, TRAJTIMIN DHE REHABILITIMIN E FËMIJËS ABUZUES ME NARKOTIKË

Neni 37

Plani i veprimit për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijës abuzues me narkotikë

1. Ministria, pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, harton Planin e veprimit për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijës abuzues me narkotikë.

2. Plani i veprimit për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijës abuzues me narkotikë duhet të jetë:
 - 2.1. me objektiva të arritshme;
 - 2.2. i mbështetur nga burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare;
 - 2.3. i bazuar në njohuritë aktuale shkencore;
 - 2.4. i monitoruar dhe vlerësuar sistematikisht nga njësi përkatëse e ministrisë, dhe
 - 2.5. me aktivitete për një periudhë të caktuar, duke marrë parasysh nevojat dhe specifikat konkrete dhe reale, si dhe duke marrë parasysh mundësitë buxhetore dhe kohën në dispozicion.
3. Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës, sipas propozimit të Ministrisë, miraton Planin e veprimit për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijës abuzues me narkotikë.

Neni 38

Procesi i hartimit dhe zbatimit të Planit të veprimit për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijës abuzues me narkotikë

Gjatë hartimit të Planit të veprimit për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijës abuzues me narkotikë, Ministria duhet të sigurojë pjesëmarrjen e institucioneve përkatëse të nivelit qendror dhe lokal, institucionet e pavarura për të drejtat e njeriut, profesionistët që punojnë për dhe me fëmijët, studiuesit, shoqëria civile dhe mediat duhet të jenë të përfshirë në hartimin, dhe vlerësimin e Planit të veprimit.

Neni 39

Monitorimi dhe vlerësimi i Planit të veprimit për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijës abuzues me narkotikë

1. Monitorimi dhe vlerësimi i Planit duhet të kryhen rregullisht nga njësi përkatëse e Ministrisë, me qëllim të identifikimit të politikave dhe masave që janë të përshtatshme dhe efektive në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga përdorimi i narkotikëve.
2. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit, janë të obliguara të raportojnë tek njësi përkatëse e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, sipas mënyrës dhe afateve të përcaktuara në Plan.

KAPITULLI VI - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 40

Njësia përkatëse për rehabilitimin dhe trajtimin e përdoruesve të narkotikëve

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, me së largu pas 1 viti, Ministria duhet të paraqesë në Qeveri nevojën për themelimin dhe funksionalizimin e një njësie përkatëse në nivel vendi për rehabilitimin dhe trajtimin e përdoruesve të narkotikëve, ku theks i posaçëm duhet të paraqitet edhe roli i kësaj njësie në trajtimin e varësisë së fëmijëve nga narkotikët.
2. Ministria përmes propozimit duhet të paraqes qëndrimet lidhur me ndërtimin dhe funksionalizimin e njësisë përkatëse në nivel vendi për rehabilitimin dhe trajtimin e përdoruesve të narkotikëve, duke ofruar modelin përkatës, që i përshtatet nevojave dhe mundësive të Kosovës dhe duke marrë parasysh përvojat e shteteve rajonale dhe me gjerë.
3. Gjatë hartimit të këtij dokumenti, Ministria duhet të:
 - 3.1. marrë parasysh gjendjen faktike në terren dhe përvojat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, Klinikës së Psikiatrisë dhe institucioneve shëndetësore dhe organizatave joqeveritare që merren me trajtimin psiko-social të fëmijës së varur nga narkotikët;
 - 3.2. paraqesë edhe buxhetin e nevojshëm për ndërtimin njësisë përkatëse në nivel vendi për rehabilitimin dhe trajtimin e përdoruesve të narkotikëve,
 - 3.3. Paraqesë gjendjen dhe nevojat e stafit profesional për të funksionalizuar njësisë përkatëse në nivel vendi për rehabilitimin dhe trajtimin e përdoruesve të narkotikëve, mënyrën dhe vendin e sigurimit të hapësirave për ndërtimin e njësisë si dhe çështjet tjera që i konsideron të nevojshme.

Neni 41

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës
03/07/ 2023